



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr. ____/2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8874 DATË 29.03.2002
“PËR KONTROLLIN E LËNDËVE QË PËRDOREN PËR FABRIKIMIN E
PALIGJSHËM TË LËNDËVE NARKOTIKE DHE PSIKOTROPE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8874 datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope” bëhen disa shtesa dhe ndryshime si vijon:

Neni 1

Ne Nenin 2 pas gërmës “h” shtohen gërmat “i”, “j”, “k” dhe “l” si vijon:

i). “Lëndë jo e listuar” do të thotë çdo lëndë e cila, edhe pse nuk është e përfshirë në Aneks, është identifikuar si e përdorur për prodhimin e paligjshëm të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope.

j). “Eksportues” do të thotë personi fizik ose juridik që është përgjegjës kryesor për veprimtaritë e eksportit, në bazë të marrëdhënies ekonomike dhe ligjore me lëndët e listuara dhe me marrësin, dhe, kur është e nevojshme, ai që paraqet deklaratën doganore ose në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore.

k). “Importues” do të thotë personi fizik ose juridik që është përgjegjës kryesor për veprimtaritë e importit, në bazë të marrëdhënies ekonomike dhe ligjore me lëndët e listuara dhe me dërguesin, dhe që paraqet deklaratën doganore ose në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore.

l) “Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve (INCB)” do të thotë organi i krijuar nga Konventa e Vetme mbi Lëndët Narkotike e vitit 1961, e ndryshuar me Protokollin e vitit 1972.

Neni 2

Neni 11 riformulohet si vijon:

“Neni 11

Deklarimi për përdorimin e parashikuar te lendes

1. Çdo porosi për një lende te listuar (kategoritë 1 dhe 2) shoqërohet nga një deklaram i përdorimit te parashikuar te saj, sipas modelit te përcaktuar ne shtojcat 7 dhe 7/1 te këtij ligji. Operatori nuk duhet te beje ne asnjë rast porosinë pa një deklaram te tille.
2. Operatori duhet të marrë një deklaratë të veçantë për secilën substancë të listuar. Kjo deklaratë duhet të jetë në përputhje me modelin e përcaktuar në shtojcen 7. Nëse operatori furnizon rregullisht të njëjtin klient me substanca të kategorisë 2, ai mund të pranojë një deklaratë të vetme vjetore, nëse klienti:
 - a) klienti është furnizuar nga operatori me substancën të paktën tre herë gjatë 12 muajve të fundit;
 - b) operatori nuk ka arsye të mendojë se substanca do të përdoret për qëllime të paligjshme;
 - c) sasi të e porositura janë në përputhje me konsumin e zakonshëm të klientit.

Kjo deklaratë duhet të jetë në përputhje me modelin e përcaktuar në shtojcen 7/1 te ketij ligji

Neni 3

Në nenin 18 pika 4 riformulohet si vijon:

4). Dokumentacioni i përmendur ne pikat 1 dhe 3 ruhen për një periudhe prej 3 vjetësh, duke filluar nga fundi i vitit kalendarik, ne te cilin është kryer operacioni i përmendur ne piken 1 dhe duhet te jete i disponueshem për inspektim nga organet përgjegjëse, sipas kërkesës se këtyre te fundit. Ky dokumentacion duhet të organizohet në mënyrë të tillë, në formë elektronike ose në letër, që të jetë lehtësisht i disponueshëm për inspektim nga autoritetet kompetente me kërkesë. Dokumentacioni mund të ruhet në formë imazhi ose në një mjet tjetër elektronik të ruajtjes së të dhënave, me kusht që, kur të bëhet i lexueshëm, të përputhet në pamje dhe përmbajtje me

dokumentacionin origjinal, të jetë gjithmonë i aksesueshëm, të mund të lexohet pa vonesë dhe të analizohet me mjete automatike.

Neni 4

Shtojca 1 dhe shtojca që i bashkëlidhen ligjit 8874/2002 zëvendësohet me Shtojcën 1 dhe 4 bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”

KRYETARI

NIKO PELESHI